



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA A REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Punëdhënësi / Prereditori Received / Delivery	26.04.2021	1	viti god year
Organ / Rrethi Organ / Jedinica Org / Unit	In Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	2010/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.137/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A. nr.137/2021, të datës 12.03.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr."Luan Haradinaj" kati XVII, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.137/2021 e datës 12.03.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, me datë 12.03.2021 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1125/2021, të regjistruar me numër A.nr.137/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e te drejtës për shfrytëzimin e reprezentacionit sipas Udhëzimit Administrativ të datës 01/2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 16.03.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Ministri e Ekonomisë dhe Ambientit, ndërsa me datë 19.03.2021 ka pranuar përgjigjen në kërkesë me numër protokollit 1281/2021, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 1125/2021, të regjistruar me numër A.nr.137/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1185/2021 të datës 16.03.2021 ; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1281/2021 të datës 19.03.2021; Listën e Distribuimit të datës 14.10.2020; Shkresën drejtuar Sekretarit nga ana e ankuesit lidhur me faturën për periudhën kohore Shtatore-2020; Faturën me numër 336158 të datës 30.09.2020 2020; Kërkesën e datës 10.02.2020; Urdhër obligimin për pagesë me numër të faturës 000271 të datës 05.02.2020; Urdhër obligimin për pagese me numër të faturës 000210- të datës 06.09.2019; Kërkesën e datës 09.09.2019; Faturën e datës 06.09.2019; Urdhër obligimin për pagese me numër të faturës 000231; Kërkesën me referencë 606-2019 të datës 13.11.2019; Kërkesën me numër 606-2019 të datës 23.11.2019; Faturën e datës 11.11.2019; Urdhër obligimin për pagese me numër të faturës 000258 të datës 16.01.2020; Kërkesën e datës 20.01.2020; Akt Emërimi me numër të protokollit 250 të datës 21.05.2019 të ankuesit

Vendimin me numër të protokollit 167-1 të datës 12.04.2019; Vendimin me numër të protokollit 136/2019 të datës 20.05.2019 si dhe përshtkrimin e detyrave të punës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa lejuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesi në bazë të Akt Emërimit me nr.250 të datës 21.05.2019 mbanë pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Komunikim me Palët" në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Ankuesi, me qëllim të realizimit të reprezentacionit sipas Udhëzimit Administrativ 01/2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 14.10.2020 ka parashtruar kërkesë të Zyrtari Kryesor Financiar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit. Sipas shkresave të lëndës, ankuesi nuk ka pranuar përgjigje me shkrim nga organi i punësimit, andaj i njëjti me datë 12.03.2021 ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ;* 2. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ*

Andaj, duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, respektivisht kërkesën e ankuesit të datës 14.10.2020 drejtuar Zyrtarit Kryesor Financiar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, konstaton se ushtrimi i ankesës me datë 12.03.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjore të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 129 paragrafi 1




nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.137/2021

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit
- Arkivot të KPMSHCK-së

